



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:069021

Datë: 16.10.2023

Numri i dokumentit: 04783699

AD.GJTH.GJL.nr.7/2023

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga ankuesi A [REDACTED] I [REDACTED] nga Prishtina, të datës 09.10.2023, për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit Besnik Pireva - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, me datë 13.10.2023, mori këtë:

**AKTVENDIM**

I. **REFUZOHET e pabazuar** ankesa e parashtruar nga ankuesi A [REDACTED] I [REDACTED] nga Prishtina, e datës 09.10.2023, për inicimin e procedurës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarit B [REDACTED] P [REDACTED] - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan.

II. Sa i përket kërkesës për përjashtim të gjyqtarit, të paguhet nga ankuesi taksa gjyqësore për përjashtim në shumë prej 30.00 euro dhe të arsyetohet në kërkesë ky përjashtim, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

**Arsyetim**

Me datë 09.10.2023, ankuesi A [REDACTED] I [REDACTED] nga Prishtina, në takimin e mbajtur me Kryetarin e Komisionit për Administrimin e Gjykatave, z.F [REDACTED] V [REDACTED] – anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka paraqitur ankesë, përkatësisht ka shprehur shqetësimet e tij ndaj gjyqtarit B [REDACTED] P [REDACTED] - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, nën arsyetimin se gjyqtari i çështjes sipas lëndës C.nr.368/23 nuk po i kryen detyrat e punës konform dispozitave ligjore dhe nuk po i dorëzon me kohë provat. Ka kërkuar që lënda e tij të bartet në kompetencë të ndonjë dege tjetër apo gjykate tjetër. Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 10.10.2023, ankesën e lartëcekur e ka kthyer tek autoriteti kompetent i kësaj gjykate, për veprime të mëtutjeshme, lidhur me pretendimet e ankuesit për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të çështjes.

Kryetari i gjykatës, më datë 11.10.2023 ka kërkuar nga gjyqtari B [REDACTED] P [REDACTED] të deklarohet lidhur me pretendimet e ankuesit.

Gjyqtari B [REDACTED] P [REDACTED] në deklaratën e tij të datës 11.10.2023 drejtuar kryetarit të gjykatës, lidhur me pretendimet e ankuesit ka theksuar se që nga pranimi i lëndës ka ndërmarrë në vazhdimësi veprime lidhur me këtë çështje kontestuese, të cilat i ka paraqitur në mënyrë kronologjike, ashtu që lënda është pranuar më datë 15.03.2023 (17.03.2023 në sistemin SMIL); më datë 14.04.2023 është kthyer në plotësim padia; më datë 08.05.2023 është marrë aktvendimi për përgjigje në padi dhe është dorëzuar kërkesa për mendim profesional organeve të kujdestarisë në Prishtinë dhe Gjilan; më datë 24.07.2023 është kërkuar plotësimi i mendimit të QPS-së, në Gjilan; dhe më datë 05.09.2023 është kthyer në plotësim padia e paditëses. Të gjitha veprimet e ndërmarra i ka ndërlidhur me plotësimet e padisë; mendimet e pranuar nga organi i kujdestarisë dhe dështimet e komunikimit të shkresave me të paditurin (këtu palën ankuese A [REDACTED] [REDACTED]), ku nga Posta e Kosovës, 4 herë rradhazi nuk është gjetur në adresën e tij, përkatësisht është konstatuar e panjohur adresa, derisa të fundit herë, është arritur komunikimi i shkresave përmes Postës së Kosovës duke shfrytëzuar nu.nrin e telefonit të tij, këtu palës ankuese, dhe nga momenti i pranimit të aktvendimit për përgjigje në padi së bashku me shkresat e lëndës më datë 02.10.2023, i njëjti ende ka afat ligjor për të parashtruar përgjigje në padi.

Kryetari i gjykatës, pas pranimit të ankesës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të paraqitur nga pala ankuese, deklaratës së paraqitur nga gjyqtari B [REDACTED] P [REDACTED] dhe analizimit të pretendimeve të ankuesit, ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkelje të mundshme disiplinore, duke vlerësuar se ankesa e palës ankuese e dt. 09.10.2023, është e pabazuar dhe pretendimet e të njëjtit nuk e justifikojnë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit në fjalë.

Deri te një përfundim i tillë, kryetari i gjykatës erdhi pas vlerësimit dhe analizimit me shumë kujdes të pretendimeve të palës ankuese të paraqitura në ankesën e tij dhe gjeti se veprimet e gjyqtarit B [REDACTED] P [REDACTED] janë ndërmarrë duke zbatuar Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin për Familje të Kosovës, përkatësisht ankuesit i janë dorëzuar shkresat e lëndës me kohë, mirëpo mungesa e komunikimit ka ndodhur për shkak të adresës së panjohur të evidentuar si në fletëkthesat e Postës së Kosovës, ndërsa gjyqtari i çështjes ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për sigurim të adresës dhe komunikim të rregullt të shkresave. Njëherit ka ndërmarrë veprimet ligjore përkitazi me Ligjin për Familje të Kosovës dhe brenda afatit ligjor. Këto veprime, kryetari i gjykatës vlerëson se nuk mund të konsiderohet që janë në kundërshtim me etikën e gjyqtarit dhe si të tilla nuk mund të cilësohen si shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit, ngase gjyqtari i çështjes nuk ka neglizhuar lëndën dhe ka vepruar sipas dispozitave ligjore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate vlerëson se gjyqtari i çështjes gjatë zbatimit të procedurës kontestimore ka vepruar në mënyrë të drejtë, brenda kompetencave dhe në përputhshmëri me autorizimet që ka sipas dispozitave të LPK-së, ashtu që në rastin konkret me veprimet procedurale që i ka ndërmarrë gjyqtari nuk përbëjnë shkelje të etikës së gjyqtarit, andaj edhe konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për

Gjyqtarë dhe Prokurorë, kryetari i kësaj gjykate ka gjetur se ankesa e ankuesit A [REDACTED] I [REDACTED] e datës 09.10.2023, është e pabazuar dhe për të njejtën ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Kryetari i gjykatës, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, meqë në ankesën e parashtruar nga ankuesi në takimin e mbajtur me Kryetarin e Komisionit për Administrimin e Gjykatave, i njëjti ka kërkuar përjashtimin e gjykatës, përkatësisht gjyqtarit dhe transferimin e lëndës në një tjetër degë apo gjykatë, mirëpo kërkesën nuk e ka arsyetuar, ndërsa në dispozitën e nenit 68.4 të LPK-së, pala që kërkon përjashtimin e gjyqtarit, duhet të arsyetojë këtë përjashtim. Në Udhëzimin Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, Nr.01/2017 është përcaktuar taksa gjyqësore sipas kërkesës për përjashtim të gjyqtarit në shumë prej 30.00 euro, prandaj ankuesi u udhëzua në pagesë të taksës dhe arsyetim të kërkesës.

Kryetari i Gjykatës

Venhar Salihu

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarit B [REDACTED] P [REDACTED]
2. Parashtruesit të ankesës,
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.